



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.11.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË LIPJANIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të përformancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Lipjanit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Florim Beqiri i mbështetur nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës Ekipi), Sabile Musa, Mexhit Ferati dhe Shpresa Zenelaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia | 8 |
| 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 9 |
| 3 Rekomandimet e vitit paraprak | 15 |
| 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli | 16 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP | 34 |
| Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak..... | 37 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të komunës së Lipjanit për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 12.12.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare, të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Reagimin ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës (duke përfshirë ekzekutimin e buxhetit dhe Auditimin e Brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare në të gjitha aspektet materiale *prezantojnë një pamje të drejt dhe të plotë*, me përjashtim të:

Te Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme - pagesat nga palët e treta, komuna nuk ka prezantuar drejt vlerën 1,588,153€. Kjo shumë nuk është e saktë, për shkakun se në totalin e këtyre pagesave ishin përfshirë edhe bashkëfinancimet nga Ministrinë e linjës në vlerë prej 1,162,937€.

Te raporti i ekzekutimit të buxhetit, komuna ka paraqitur si ndarje të buxhetit vlerën prej 1,949,000€, ndërsa sipas raportit të Free balancit kjo vlerë duhet të jetë 1,700,000€. Diferenca është 249,000€.

Theksim i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat për shpalosjet e obligimeve të papaguara dhe pasurive nuk ishin të sakta. Pasaktësitë janë:

Në totalin e prezantuar prej 1,246,034€, të obligimeve të papaguara, ishin përfshirë edhe 83,196€, fatura të muajt janarit të vitit 2014.

Te përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale pasuria e paraqitur me vlerë mbi 1,000€, në PVF ishte 173,655,000€. Kjo pasuri nuk është e plotë dhe e saktë për arsye se kishte pasuri që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF.

Investimet kapitale ishin të mbivlerësuara për 53,281€, sepse kjo shumë ishte shpenzuar për paga dhe mëditje.

(SNISA 200: Opinion i Kualifikuar me theksim të çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrole nuk ishin mjaft efektive në disa fusha kyçe të menaxhimit financiar. Në veçanti, ne kemi identifikuar:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, Pasqyrat Vjetore Financiare të paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Disa janë ndryshuar në versionin final të Pasqyrave Vjetore Financiare, por menaxhmenti zgjodhi t'i linte disa zëra të pakorrigjuara;
- Rreziqet domethënëse që ishin materializuar ishte Raportimi i gabuar i pagesave nga palët e treta në shumën prej 1,588,153€. Në totalin e këtyre pagesave përfshihen edhe pagesat (bashkëfinancimet) për projekte të ndryshme të kryera nga MAPL, MASHT dhe Ministria e Infrastrukturës në vlerë prej 1,162,937€;
- Rrezik tjetër domethënës në PVF ishte regjistrimi i gabuar i pasurive, për arsye se janë identifikuar pasuri nga ana e komisionit që nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurive;

- Niveli i implementimit të rekomandimeve nga viti i mëparshëm është shumë i ultë. Komuna, prej 21 rekomandimeve të dhëna, kishte adresuar plotësisht vetëm pesë prej tyre. Kjo ka shkakuar që disa nga dobësitë të përsëriten, madje në forma edhe më të theksuara;
- Ekzekutimi i buxhetit final, ndonëse në shkallë totale arrin në 92%, fondet buxhetore për investime kapitale ishin shpenzuar në një shkallë relativisht të ultë (86%), ndërsa për mallra dhe shërbime vetëm 68%. Kjo kishte ndodhë për shkak të dështimit të planit në mbledhjen e të hyrave vetjake;
- Ne kemi vërejtur dobësi serioze në nivelin e kontrollit të lartë. Problemet i takojnë natyrës së komunikimit dhe informimit. Ka mungesë të raportimeve të rregullta mbi mbarëvajtjen e operacioneve të përditshme të komunës;
- Trendi jonormal i inkasimit të të hyrave ngrit nevojën e një planifikimi shumë më të mirë të burimeve vetjake financiare. Të hyrat e mbledhura në vitin 2013 ishin 8% më të mëdha se ato në vitin 2012, por 30% më të ultë se në vitin 2011. Duket se komuna nuk ka konsistencë në planifikim dhe si rezultat i kësaj, inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë ishte për gjysmë më i ultë sesa ishte planifikuar. Një menaxhim i dobët i të hyrave vërehet edhe tek inkasimi i qirave për pronat publike të dhëna në shfrytëzim. Gati 80 mijë euro janë grumbulluar si llogari të arkëtueshme nga qiraja;
- Prokurimi, gjithashtu, është përcjellë me mangësi serioze. Krahas mangësive në administrimin e procedurave, komuna kishte hyrë në kontrata prej 5,9 milionësh, duke zotuar vetëm 1,7 milionë;
- Për shkak të dështimeve të kontrolleve menaxheriale, në fund të vitit komuna ka prezantuar obligime të pa paguara për paga prej 288,474€, për shkak të mbetjes së disa punonjësve arsimor jashtë listës së pagave. Janë identifikuar edhe pa rregullsi të pagesave të pushimeve të lehonisë;
- Menaxhimi i dobët i subvencioneve është reflektuar me pagesat pa bazë të qartë ligjore, duke iu shmangur zbatimit të kriterëve të përcaktuara si dhe duke kryer pagesa për mallra dhe shërbime përmes subvencioneve; dhe
- Adresimi i dobët i rekomandimeve të auditimit të brendshëm, të cilat kanë rezultuar me përsëritjen e rekomandimeve, dhe dobësive dhe mangësive sistematike.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë si në vijim:

Kryetari duhet të sigurojë:

- Që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme. Stafi përgjegjës për përgatitjen e Pasqyrave

Vjetore Financiare duhet të ketë kompetencën e duhur profesionale, ose të ndjekë trajnime shtesë në këtë fushë;

- Që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një vlerësim rigoroz që plotësisht pasqyron të gjitha informatat relevante, duke përfshirë shpenzimet kundrejt të hyrave gjatë vitit të kaluar dhe ndryshimet që priten gjatë vitit, etj. Monitorim efektiv gjatë vitit duhet të zbatohet dhe veprimet e duhura të merren për të adresuar variancat kundrejt shpenzimeve të planifikuara;
- Masa të shpejta dhe të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar, përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato;
- Një rishikim sistematik dhe të përcaktoj pengesat në rritjen e të hyrave vetjake dhe reduktimin e nivelit të borxheve historike dhe të identifikoj mundësitë e përmirësimit të situatës aktuale. Komuna duhet t'u referohet komunave tjera të ngjashme dhe të zbatoj praktikat efektive të tyre nëse ato mund të zbatohen nën kushtet e njëjta;
- Një vlerësim të detajuar të procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për ti adresuar këto dobësi;
- Duhet të diskutojë me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë se si mund të mbulohen detyrimet;
- Se kontratat për punë aprovohen vetëm nëse ka buxhet të mjaftueshëm dhe pozita të lira, si dhe t'i shqyrtoj rastet e identifikuar të mos pagesave të stafit. Po ashtu, duhet të merr masa të shpejta për hartimin e një rregulloreje të subvencioneve, të rishikoj pagesat e parregullta dhe pse kriteret ekzistuese nuk janë zbatuar, dhe të vendos kontrolle shtesë për të siguruar që rastet e tilla të mos përsëriten edhe në të ardhmen; dhe
- Se të gjitha nivelet menaxhuese do të marrin në konsiderim këshillat dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm, si dhe herë pas here të monitoroj procesin nëse auditimi i brendshëm po i arrin efektet.

Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë një pamje të drejt dhe të plotë, me përjashtim të:

Te Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme - pagesat nga palët e treta, komuna nuk ka prezantuar drejt vlerën 1,588,153€. Kjo shumë nuk është e saktë, për shkakun se në totalin e këtyre pagesave ishin përfshirë edhe bashkëfinancimet nga Ministrinë e linjës në vlerë prej 1,162,937€.

Te raporti i ekzekutimit të buxhetit, komuna ka paraqitur si ndarje të buxhetit vlerën prej 1,949,000€, ndërsa sipas raportit të Free balancit kjo vlerë duhet të jetë 1,700,000€. Diferenca është 249,000€.

Theksim i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat për shpalosjet e obligimeve të papaguara dhe pasurive nuk ishin të sakta. Pasaktësitë janë:

Në totalin e prezantuar prej 1,246,034€, të obligimeve të papaguara, ishin përfshirë edhe 83,196€, fatura të muajt janarit të vitit 2014.

Te përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale pasuria e paraqitur me vlerë mbi 1,000€, në PVF ishte 173,655,000€. Kjo pasuri nuk është e plotë dhe e saktë për arsye se kishte pasuri që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF.

Investimet kapitale ishin të mbivlerësuara për 53,281€, sepse kjo shumë ishte shpenzuar për paga dhe mëditje.

(SNISA 200 Opinion i Kualifikuar me theksim të çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 12.12.2013, ishin identifikuar dy rreziqe domethënëse: atë për regjistrimin e pasurive dhe shpalosjen e pagesave nga palët e treta.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me regjistrimin dhe prezantimin e pasurive, identifikimin e pagesave nga palët e treta dhe prezantimin e tyre në PVF-të ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Prezantim i gabuar i pagesave nga palët e treta

E gjetura

Gjatë ekzaminimit të PVF-ve, në shtyllën e pagesave nga palët e treta, kemi vërejtur se komuna ka regjistruar shumën prej 1,588,153€. Kjo shumë nuk është e saktë, për shkakun se në totalin e këtyre pagesave janë përfshirë edhe bashkëfinancimet për projekte të ndryshme nga MAPL, MASHT dhe Ministria e Infrastrukturës në vlerë prej 1,162,937€.

Këto vlera të shpenzuara janë të regjistruara si shpenzime nëpër evidencat kontabël të këtyre ministrive, dhe meqenëse janë bërë nga Llogaria e Vetme e Thesarit, nuk mund të trajtohen si pagesa të palëve të treta. Keq pohimi material lidhur me këto pagesa mund të shpie në modifikimin e opinionit.

Rekomandimi 1 Prioriteti i lartë - Kryetari duhet të analizoj arsyet për keq deklarimet lidhur me pagesat nga palët e treta dhe të siguroj se pagesat nga palët e treta të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PVF-të e vitit 2014.

Rreziku i identifikuar

Çështja 2 - Pasuritë nën pronësi të komunës nuk janë identifikuar dhe regjistruar në mënyrën e duhur, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e pasurive në PVF

E gjetura

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar se a janë regjistruar të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës në regjistrat e pasurive. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar pasi që menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të prezantuara në PVF janë të pasakta, për arsye se janë identifikuar pasuri nga ana e komisionit që nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurive.

Rekomandimi 2 Prioritet i lartë – Kryetari duhet të analizoj arsyet pse këto pasuri nuk janë regjistruar dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontroleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare (RrF) nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA (Kryetari i Komunës) dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore në Kuvendin Komunal dhe një kopje tek Ministri i MF gjatë vitit 2013.

Ne kemi identifikuar mos pajtueshmërinë si në vijim:

Në draft PVF ishte e nevojshme që të bëheshin disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për të përmirësuar këto pasaktësi. Megjithatë, korrigjimet e duhura nuk janë bërë. Marrë parasysh atë që u tha më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet si e mangët për pjesën e pagesave nga palët e treta, ekzekutimin e buxhetit, obligimet e paguara dhe pasuritë.

Çështja 3 - Procesi i përgatitjes së Pasqyrave vjetore financiare - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Te neni 12 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme tek shtylla - pagesat nga palët e treta komuna nuk ka prezantuar drejt vlerën 1,588,153€. Për më shumë referoju kapitullit 2.2 të këtij raporti.
- Te neni 13 Raporti i ekzekutimit të buxhetit, te shënimi 16 shtylla e buxhetit final, komuna ka paraqitur si ndarje të buxhetit vlerën prej 1,949,000€, ndërsa sipas raportit të Free balancit kjo vlerë duhet të jetë 1,700,000€. Diferenca është 249,000€.
- Investimet kapitale ishin të mbivlerësuara për 53,281€, sepse kjo shumë ishte shpenzuar për paga dhe mëditje.
- Shënimi 31 Pasqyra e obligimeve të papaguara – Në totalin e prezantuar prej 1,246,034€, si obligime të mbetura, ishin përfshirë edhe 83,196€, fatura të muajt janarit të vitit 2014.
- Te shënimi 30 Përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale pasuria e paraqitur me vlerë mbi 1,000€, në PVF është 173,655,000€. Kjo pasuri nuk është e plotë dhe e saktë për arsye se janë konfirmuar pasuri nga ana e komisionit komunal që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF,
- Rreziku** Pasqyrat vjetore financiare nuk janë të plota, sidomos tek pagesat nga palët e treta, raportimi i shpenzimeve dhe pjesa e pasurive. Regjistrat e kontabilitetit janë të pamjaftueshëm për të mbështetur vendimin e menaxhmentit për të bërë proceset dhe konsideratat e gjera buxhetore.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që kërkesa nga plani i hartimit të PVF 2014 për rishikimin e draft llogarisë nga menaxhmenti zbatohet me fokus të veçantë në fushat ku pasqyrat kishin mangësi. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante për PVF-të.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në MF;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK-së);
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve; dhe
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto, pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm. Po ashtu, plotësimi i kërkesave ka qenë i cilësisë së mirë dhe në pajtim me afatet kohore që janë kërkuar.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i Komunës kishte përgatitur Planin e Veprimit lidhur për zbatimin e rekomandimeve dhe ne kemi vërejtur se pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit paraprak nuk ishin adresuar. Për një përshkrim të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2012 kishte rezultuar në 21 rekomandime.

Në fund të auditimit ne kemi vërejtur se pesë rekomandime ishin adresuar plotësisht; tri ishin adresuar pjesërisht apo janë në proces të adresimit, dhe 13 nuk ishin adresuar.

Çështja 4 - Adresim i dobët i rekomandimeve të vitit paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar ishin adresuar, sepse Menaxhmenti nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet financiare kyçe, si Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë rezultuar në:

- Menaxhim jo i mirë i buxhetit;
- Mungesë e kontrolleve të mjaftueshme në planifikimin dhe inkasimin e të hyrave;
- Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ dhe vlera e dobët për para në praktikën e prokurimit;
- Pagesa të parregullta të faturave dhe të subvencioneve; dhe
- Hyrja në kontrata pa zotimin e fondeve, pranimi i stafit përtej buxhetit të aprovuar, etj.

Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se një plan i rishikuar, praktik njëkohësisht edhe sfidues, është hartuar për të adresuar rekomandimet e bëra nga AP duke caktuar stafin përgjegjës me një fokus fillestar në fushat më të rëndësishme. Zbatimi i këtij plani duhet të rishikohet nga kryetari në baza mujore.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo nuk po zbatohen në praktikë dhe nuk po funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e Komunës të ndërmarrë në kuadër të MFP në lidhje me vetë-vlerësimin e KBFP.

Ne kemi gjetur se nevojitet një përmirësim i dukshëm i kontrolleve në të gjitha fushat, në mënyrë që të parandalojnë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të aktiviteteve operative. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: Paga dhe Mëditje, Prokurimi, Të hyrat, Subvencionet, Menaxhimi i pasurisë dhe Obligimet e papaguara.

4.2 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja 5 - Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë - Prioritet i lartë

E gjetura Rishikimi që ne i kemi bërë kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah se dobësitë në kontrollet e nivelit të lartë janë serioze. Problemet i takojnë natyrës së komunikimit dhe informimit. Mungesa e raportimeve të rregullta mbi mbarëvajtjen e operacioneve të përditshme të komunës ka shkaktuar dobësi domethënëse në menaxhim, që për pasojë kanë patur parregullsitë e identifikuar më lart në përmbledhje të këtij raporti.

Rreziku Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për ti adresuar ato. Përveç kësaj, shfaqja e parregullsive potenciale mbetet rrezik i vazhdueshëm.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të merr masa të shpejta dhe të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar, përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato.

4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ¹ | 2013 Shpenzimi | 2012 Shpenzimi | 2011 Shpenzimi |
|---------------------------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e Fondeve: | 11,993,341 | 12,305,133 | 11,269,304 | 11,351,262 | 11,665,699 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 10,293,341 | 10,293,341 | 10,156,396 | 10,140,584 | 9,874,397 |
| Të bartura nga viti paraprak ² - | | 248,562 | 232,968 | 313,996 | 479,741 |
| Të hyrat vetanake ³ | 1,700,000 | 1,700,000 | 822,940 | 880,766 | 1,280,050 |
| Donacionet e brendshme | | 5,848 | 0 | 10,000 | 0 |
| Donacionet e jashtme | | 57,382 | 57,000 | 5,916 | 31,511 |

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 311,792€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore, të jashtme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak.

Në vitin 2013 komuna ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 11,269,304€, përderisa në vitin 2012 buxheti ishte shpenzuar 95%, që mund të konsiderohet si një performancë mjaft e mirë buxhatore.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2013 Shpenzimi | 2012 Shpenzimi | 2011 Shpenzimi |
|---------------------------------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 11,993,341 | 12,305,134 | 11,269,304 | 11,351,262 | 11,665,699 |
| Pagat dhe Mëditjet | 6,780,898 | 6,789,328 | 6,738,235 | 6,744,399 | 6,580,682 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 1,199,710 | 1,193,056 | 815,574 | 742,386 | 752,815 |
| Shërbimet komunale | 256,500 | 256,594 | 204,747 | 119,972 | 130,708 |
| Subvencionet dhe Transferet | 150,000 | 184,866 | 179,550 | 138,064 | 88,273 |
| Investimet Kapitale | 3,606,233 | 3,881,290 | 3,331,198 | 3,606,441 | 4,113,221 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit të Investimet Kapitale ishte bërë një pjesë nga të hyrat e bartura në vlerë prej 212,000€, dhe 63,000€ prej donatorëve. Buxheti të kjo kategori ishte shpenzuar 86%. Mosrealizimi i 500,000€ të planifikuara nga të hyrat vetanake kishte ndikime direkte në realizimin e projekteve kapitale. Nga tabela shihet se komuna ishte shumë më efektive në realizimin e projekteve kapitale në dy vitet paraprake.
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte reduktuar për 6,654€. Pavarësisht reduktimit për këtë kategori, gjatë vitit janë shpenzuar vetëm 68% e buxhetit. Kjo tepricë buxhetore ka rezultuar nga fakti se komuna nuk kishte bërë kalkulimet e sakta të fondeve të duhura për këtë kategori shpenzimesh.
- Rritja e buxhetit për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve kishte ndodhur me rishikim të buxhetit prej 35,000€. Kjo rritje është si rezultat i transferit të mjeteve nga kategoria Mallra dhe Shërbimeve dhe nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak.

Asnjë vit të hyrat vetanake nuk shpenzohen në tërësi, si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit, duke pasur parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë mbi 395,000€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në euro)

| Përshkrimi | Buxheti Fillestar | Buxheti Final | 2013 Pranimi | 2012 Pranimi | 2011 Pranimi |
|-------------------|-------------------|---------------|--------------|--------------|--------------|
| Të hyrat vetanake | 1,700,000 | 1,700,000 | 1,202,414 | 1,111,359 | 1,570,134 |

Siç shihet nga tabela, të hyrat e planifikuara për vitin 2013 janë 1,700,000€, ndërsa pranimet e të hyrave ishin 1,202,414€ apo 71% duke përfshirë edhe gjobat e gjykatave dhe dënimet e policisë. Pjesa kryesore e të hyrave ishin realizuar nga tatimi në pronë (41%). Përqindja e realizimit të hyrave është relativisht e ulët. Variancat e shumave në mbledhjen e të hyrave në tri vitet e fundit janë të dukshme. Ka një rritje në krahasim me vitin 2012, por një rënie shumë të theksuar në krahasim me vitin 2011.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj komunës kanë kaluar shifrën prej 3.4 milionë, që paraqet një shumë domethënëse. Gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

Çështja 6 - Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Buxheti, në veçanti, për investime kapitale, dhe mallra dhe shërbime nuk ishte planifikuar mirë dhe nuk ishte bazuar në trendin e shpenzimeve të realizuara në vitet e kaluara për kategoritë përkatëse. Nuk kishte një plan të mirë as për alokimin e fondeve gjatë vitit. Rreth 52% e buxhetit për investime kapitale ishte shpenzuar në tremujorin e fund vitit.
- Rreziku** Ekziston një mospërputhje e lartë në mes planit dhe shpenzimeve. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët në kategoritë e përmendura, mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave organizative (shpenzimeve të planifikuara) dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj se procesit të buxhetimit i paraprinë një analizë e plotë dhe vlerësim kritik për të gjitha kategoritë, me fokus të veçantë, projektet kapitale. Kryetari duhet të monitoroj performancën buxhetore në baza periodike dhe të adresoj pengesat që dalin në proces për realizimin e projekteve kapitale në mënyrë që të sigurohet se projektet po realizohen dhe objektivat po arrihen.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara në vitin 2013 ishin 1,202,414€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: Të hyrat nga tatimi në pronë; Licenca tjera për afarizëm etj.

Çështja 7 - Tatimi në pronë - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna për vitin 2013 kishte faturuar 18,925 obligues të tatimit në pronë në vlerë 1,009,798€, ndërsa kishte arritur të inkasoj 493,668€, as gjysmën e shumës së faturuar. Ne kemi testuar 13 mostra me vlerë 58,361€, ku komuna kishte lidhur marrëveshje me obliguesit tatimor për t'i kryer obligimet me këste, dhe kemi vërejtur se këta obligues kishin paguar vetëm këstin e parë me vlerë prej 16,036€. Komuna nuk kishte trajtuar këtë çështje në mënyrë sistematike, dhe pagesat e aranzhuara nuk ishin realizuar.

Rreziku Duke qenë se tatimi në pronë është burimi kryesor i të hyrave të komunës, dështimi në planin e inkasimit ka ndikime direkte edhe në realizimin e projekteve kapitale dhe financimeve tjera të parashikuara nga ky burim.

Rekomandimi 7 Kryetari i Komunës duhet të rishikoj sistemet ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur komuna për mbledhjen e të hyrave janë duke funksionuar në mënyrë efektive. Në të kundërtën, të ndërmarr veprime shtesë që të siguroj se tatimet mbliidhen në nivelet e parashikuara.

Çështja 8 - Lejet e ndërtimit - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nga lejet e ndërtimit kishte planifikuar që të realizoj 150,000€, ndërsa kishte inkasuar 17,744€ apo 12% bazë diskutimeve që kemi pasur me personat përgjegjës kanë thënë se Ministria e Financave na ka ngritur planifikimin për të hyra për vitin 2013 dhe kjo pastaj ka rezultuar që mos ketë një realizim të kënaqshëm nga kjo kategori.

Duke u bazuar në raportin e inspektoratit gjatë vitit 2013 ishin identifikuar 27 raste të ndërtimeve pa leje, mirëpo inspektorati nuk ka nxjerr aktvendime për rrënimin e këtyre objekteve dhe as që ishin inkasuar taksat për ndërtime.

Ne kemi vërejtur se objekti kolektiv Dino Sh.P.K. nuk ishte pajisur me leje të ndërtimit arsyeja sipas aktvendimit ishte se nuk i plotësonte kushtet ndërtimore, ndërsa sipas raportit të inspektoratit ndërtimi ishte përfunduar pa u pajisur me leje të ndërtimi me etazhitet (B+P+7). Po ashtu, në një rast një person fizik kishte aplikuar për leje ndërtimi objekt kolektiv me etazhitet (B+P+6 dhe B+P+1) objekti nuk ishte pajisur me leje të ndërtimit për arsye se nuk i plotësonte kushtet e ndërtimit, ndërsa sipas inspektoratit punimet veç kishin përfunduar.

Rreziku Ndërtimi i objekteve pa leje ka ndikime negative në degradimin e planit hapësinor dhe zhvillimor të komunës. Përveç kësaj, shmangia nga pagesat e taksave për leje ndërtimore ndikon në realizimin e ultë të të hyrave vetjake, dhe rrjedhimisht, edhe në vetëfinancimin e projekteve tjera të infrastrukturës përcjellëse për këto objekte.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do merren masa të shpejta që ky problem të adresohet me prioritet. Rastet si të tilla duhet të trajtohen veç e veç, dhe të vlerësohet nëse këto objekte mund të legalizohen dhe cilat prej tyre duhet të rrënohen. Po ashtu, është e nevojshme që planet rregullative të diskutohen dhe miratohen, në mënyrë që investitorët, t'iu shmangen ndërtimeve pa leje. Duhet të ndërmerren masa administrative sipas nevojës.

Çështja 9 - Të hyrat nga pronat e dhëna me qira - Prioritet i lartë

E gjetura Planifikimi i të hyrave nga qiraja ishte 71,000€, kurse realizimi 48,138€. Prej tyre, 69% janë realizuar vetëm gjatë muajit dhjetor.

Komuna kishte lidhur 62 kontrata për qiradhënie të tokave dhe lokaleve afariste. Prej tyre, 51 qiramarrës kishin borxhe të grumbulluara dhe të papaguara prej 79,029€. Komuna kishte ndërprerë kontratat për 19 raste, mirëpo ende nuk janë ndërmarr hapa për mbledhjen e borxheve të mbetura nga të tjerët.

Rreziku Komuna ka kontrolle të dobëta mbi pronat e veta. Mungesa e veprimeve me kohë për inkasimin e qirave mujore dhe azhurnimin e kontratave për shfrytëzim të pronës komunale, rritë rrezikun që shfrytëzuesit e këtyre lokaleve të mos kryejnë obligimet financiare ndaj komunës dhe këto borxhe të bëhen të pa mbledhshme apo të shndërrohen në borxhe të këqija.

Rekomandimi 9 Kryetari i Komunës duhet të rishqyrtoj në Asamblenë komunale çështjen e kontratave të skaduara, dhe aty ku e vlerëson të arsyeshme, të vazhdoj kohëzgjatjen e kontratave. Në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike për shfrytëzuesit që nuk posedojnë kontratat valide.

4.5 Shpenzimet

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Komuna ndonëse ka të dizajnuara kontrolle formale mbi shpenzimet, nga testimet tona ka rezultuar se ato nuk operojnë në mënyrën e duhur. Nënshkrimi i kontratave pa zotime të mjaftueshme, shpërblimi i ofertuesve të papërgjegjshëm, janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontrolleve.

Shpenzimet që kanë kaluar nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2013 ishin në vlerë prej 3,681,096€.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim lidhur me projektet e parapara që të realizohen gjatë vitit. Ne kemi vlerësuar se nuk është respektuar në përpikëri sistemi i PIP-it pasi që ka raste kur kontratat e nënshkruara për vitin 2013 kanë qenë të parapara me PIP, por për këto kontrata nuk është planifikuar buxhet për vitet e ardhshme (2014 dhe 2015), siç është rasti me 19 kontrata të paraqitura në vijim:

Çështja 10 - Hyrja në obligime pa disponueshmëri të mjeteve, pa zotime të mjaftueshme dhe shpërblimi i ofertuesve të papërgjegjshëm - Prioritet i lartë

E gjetura Te kontrata “Ndërtimi i shkollës në Bujari” me vlerë 392,844€, mungon deklarata mbi disponueshmëria e mjeteve. Zotimi për këtë kontratë ishte bërë vetëm 3,035€. Buxhet i paraparë për këtë projekt për vitin 2013 ishte 50,000€, ndërsa për vitin 2014 dhe 2015 nuk ka buxhet të planifikuar për tu realizuar kjo kontratë.

Po ashtu Komuna gjatë vitit 2013 kishte nënshkruar 19 kontrata për investime kapitale pa mjete të mjaftueshme me vlerë prej 5,926,545€. Gjithsej vlera e parashikuar dhe e zotuar për këto kontrata ishte 1,656,867€. Diferenca e kontratave me shumat e zotuar është 4,269,678€.

Te kontrata “Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të Institucioneve Komunale” me vlerë 129,559€, njëri nga kriteret e vendosura në njoftimin për kontratë ishte që operatori ekonomik (OE) të ketë kontrata të punëtorëve si dhe pagesat e tatimit të punëtorëve për tre muajt e fundit. Në dosjen e kompanisë fituese mungonin dëshmitë se obligimet e pagesës së tatimit për punëtorët janë kryer.

Rreziku Hyrja në kontrata pa zotimet përkatëse të fondeve dhe mos planifikimi adekuat i buxhetit për projektet shumëvjeçare rritë rrezikun që realizimi i projekteve të dështoj, si dhe të sjellë komunën në vështirësi financiare, me mundësinë që të përballet edhe me konteste gjyqësore. Gjithashtu, mungesa e deklaratës për disponueshmërinë e mjeteve dhe shmangia nga kriteret e kërkuara, paraqet mangësi në administrimin e procedurave.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet të zbatoj një rishikim të brendshëm që të përcaktoj pse kërkesat specifike të prokurimit nuk janë adresuar në rastet e mësipërme, dhe të vendos kontrolle shtesë që të gjitha dobësitë e identifikuara të adresohen në mënyrë efektive.

Çështja 11 - Vlerësim jo i drejt i tenderit- Prioritet i lart

E gjetura Te kontrata Asfaltimi i rrugës “Shqipëria dhe Haradin Bajrami” me vlerë 2,888,108€, komuna kishte eliminuar OE që kishte ofruar çmimin më të lirë me arsyetim se ishte i papërgjegjshëm. Oferta e OE Eskavatorin dhe Bascom kishte vlerën 2,289,197€ apo 598,911€ më lirë se oferta e fituesit. OE me çmim më të lirë ishte ankuar në OSHP, ku paneli shqyrtues i OSHP-së me datën 16.07.2013 kishte shqyrtuar ankesën dhe kishte vendosur për ta kthyer lëndën në rivlerësim me arsyetimin se operatori i eliminuar me çmim më të lirë ishte i përgjegjshëm për ato kritere që është eliminuar. Komuna kishte rivlerësuar edhe një herë tenderin dhe EO e njëjtë me çmim më të lirë e kishte eliminuar me arsye se nuk i përmbush prapë të njëjtat kritere sikurse herën e parë. Përsëri OE me çmim më të lirë ankohet në OSHP dhe eksperti shqyrtues i OSHP-së me datën 28.08.2013 jep mendim që lënda të shkoj në rivlerësim. Komuna nuk ka marr parasysh mendimin e ekspertit, dhe me datë 13.09.2013 nënshkruan kontratë me operatorin që ofertën e kishte me çmim më të lartë.

Rreziku Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit nga AK rrit rrezikun që të shpërblehen ofertat me çmim më të lart dhe komunës t’i shkaktohen humbje të konsiderueshme financiare.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës të analizoj arsyet pse vendimet e OSHP-së nuk janë zbatuar në këtë rast, të shtoj kontrollet tek procesi i vlerësimit të tenderëve në mënyrë që të ketë trajtim të barabartë të OE-ve gjatë vlerësimit të ofertave dhe rastet e tilla të mos përsëriten.

Çështja 12 - Kontrollë të dobëta tek procesi i prokurimit - Prioritet i lart

- E gjetura** Te kontrata “Rregullimi i Kanalizimit Fekal në Fshatin Konjuh” me vlerë 90,220€, kemi vërejtur se mungojnë këto dokumente: Deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve, mungon vendimi për formimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, format standarde mbi njoftimin e eliminimit të OE-ve. Raporti i vlerësimit është i mangët për arsye se i mungon pjesa ku komisioni rekomandon se cila kompani është fituese e tenderit si dhe mungon nënshkrimi i menaxherit të prokurimit në këtë raport.
- Rreziku** Dështimi për të ndjekur me konsistencë procedurat e prokurimit dhe udhëzuesit përkatës ka rezultuar që të lidhen kontrata në mënyrë jo të rregullt.
- Rekomandimi 12** Kryetari i Komunës duhet të siguroj një monitorim më efektiv të proceseve të prokurimit përmes menaxherit të prokurimit, në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollët që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 65 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike (MAP). Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientët janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave dhe konstatuam se çështjet e cekura janë në pajtim me kërkesat ligjore. Testet tona në këtë kategori kanë identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 13 - Punëtorët jashtë listës së pagave dhe kontrole të dobëta tek procesimi i pagesave- Prioritet i lartë

E gjetura Numri i të punësuarve në arsim, i lënë jashtë listës së pagave është rritur nga 66 sa ishte në vitin 2012 në 71 për vitin 2013. Obligimet e pa paguara të pagave sipas PVF-ve ndaj të punësuarve ishin 287,032€.

Tre të punësuar më 01.09.2012 si punëtor teknik në shkollën profesionale Adem Gllavica me pagë bazë 216€ në muaj ishin paguar sipas gradës profesor me pagë prej 353€ në muaj. Dy prej tyre deri në muajin shkurt 2013, ndërsa njëri prej tyre deri në fund të vitit 2013 që është në kundërshtim me kontratat e nënshkruara.

Në tri, nga 15 rastet e rishikuara të pushimeve të lehonisë të punëtorëve të arsimit nuk ishin bërë ndalesat e pagesave siç kërkohet me ligjin e punës. Në dy raste komuna i kishte paguar me 100% të pagës për 6 mujorin e parë ndërsa pagesa është dashtë të bëhet 70% e pagës bazë. Rast i njëjtë është edhe pagesa e plotë e një punëtoreje me pagë 100% e cila ka shkuar në pushim në muajin shtator 2012 për të cilën nuk janë bërë fare ndryshimet në payroll.

Rreziku Mos pagesa e punonjësve për kontributet e tyre, i sjellë stafin e punësuar në vështirësi financiare dhe rrit rrezikun e padive gjyqësore. Kjo do të rezultonte në kosto financiare për komunën, duke ndikuar dëmtimin e buxhetit dhe proceset e rekrutimit në të ardhmen. Për rastet e mëposhtme, zyra e personelit nuk ka azhurnuar dosjen e personelit dhe për pasojë kanë ndodhë pagesa jo korrekte..

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se kontratat për punë aprovohen vetëm nëse ka buxhet të mjaftueshëm dhe pozita të lira. Brenda një periudhe të specifikuar kohore, një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë dhe pagesat mbështeten në dokumentacionin e vlefshëm.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere gjatë vitit 2013 kanë qenë 184,866€ ndërsa të realizuara 179,550€. Për testim kemi marrë gjithsej 20 mostra në vlerë prej 96,794€, apo rreth 54%.

Çështja 14 - Mungesa e bazës ligjore dhe mungesë e raportimeve nga përfituesit e subvencioneve - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna gjatë vitit 2013 nuk kishte një rregullore të shkruar për subvencione dhe transfere.

Me vendim të kryetarit të datës 19.02.2013 ishin ndarë mjete për Sindikatë të Punëtorëve në vlerë prej 28,500€ për mbulimin e obligimeve të krijuara nga sindikata për organizimin e ekskursionit dy ditor në Durrës në muajin shtator 2012, si dhe ndihmës financiare për festat e Vitit të Ri për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike.

Në një rast komuna ka subvencionuar klubin futbollistik Ulpiana me vendim të Kryetarit të datës 29.01.2013 në vlerë 17,000€. Sipas kërkesës së kryesisë së klubit të datës 15.01.2013 këto mjete do të shfrytëzoheshin për pagesa të referëve, mirëmbajtje të terrenit, pagesa të trajnerëve, pagesa të lojtarëve etj. Sipas dëshmimeve të ofruara nga klubi, rreth 13,497€ janë shpenzuar për pagesa të borxheve të grumbulluara në administratën tatimore dhe trustin pensional nga muaji gusht 2009 deri në prill 2013 që është në kundërshtim me kërkesën e aprovuar.

Për dy punëtor të komunës Kryetari i Komunës ka ndarë mjete financiare nga 1,100€. Në kërkesat e parashtruara nga këta të punësuar specifikohet vetëm shuma e kërkuar pa ndonjë qëllim të caktuar.

Në një rast tjetër, Kryetari i Komunës kishte marrë vendim që të ndajë mjete financiare për një punëtorë të komunës në vlerë prej 350€ për pagesën e semestrit të studimeve master në Fakultetin Juridik pa ndonjë kriter të caktuar. Nuk ishte sjell dëshmi nga përfituesi lidhur me pagesën e këtyre mjeteve sipas qëllimit të destinuar. Raste identike janë edhe ndarja e mjeteve për dy studentë tjerë për pagesa të semestrave në vlerë nga 300€.

Me datë 21.02.2013 Kryetari i Komunës kishte marr vendim për ndarjen e mjeteve prej 5,000€ si subvencion Shoqatës së Gazetarëve- DEBATI për blerjen e pajisjeve për botimin e gazetës Ulpiana Press. Me këtë vendim ishte obliguar përfituesi që të raportoj në përputhje me specifikacionin e shpenzimeve të aprovuar. Nuk ishte ofruar dëshmi lidhur me destinimin e këtyre mjeteve sipas planit të aprovuar. Raste të njëjta janë edhe: Subvencionimi i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal - LIPJANI për projektin "Te festojmë bashkërisht përvjetorin e V të pavarësisë" në vlerë 1,000€, dhe Subvencionimi i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve - LIPJANI për projektet "Përgatitja e programit artistik me rastin e V vjetorit të pavarësisë" në vlerë 1,325€, dhe "Blerja e gardërobës" në vlerë 2,000€.

Rreziku Shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere nuk kanë arritur qëllimin, dhe si të tilla janë në kundërshtim me rregullat financiare. Mungesa e politikave/rregulloreve të brendshme, gjithashtu reflekton mangësinë e procedurave që duhet ndiqen me rastin e subvencionimeve.

Rekomandimi 14 Kryetari i Komunës duhet që pa vonesë të miratoj një Rregullore që specifikon qartë kriteret dhe burimet e subvencioneve. Gjithashtu, duhet t'i rishqyrtoj rastet e përmendura dhe të përcaktoj pse kontrollet nuk janë aplikuar dhe të vendos kontrolle shtesë dhe të ndërmerr masa administrative në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.

Çështja 15 - Subvencionet janë shpenzuar për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte paguar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve vlerën prej 1,660€ për blerjen e ftesave, njoftimeve, kupave, medaljeve dhe mbishkrimeve për programin festiv me rastin e pesë vjetorit të ditës së pavarësisë duke u mbështetur në vendimin e kryetarit të datës 07.02.2013. Rast i njëjtë është edhe pagesa në vlerë 900€ e shpenzimeve të transportit. Pagesa e mallrave dhe shërbimeve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve është në kundërshtim me rregullën 01 të Thesarit.

Rreziku Pagesat nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për mallra dhe shërbime rrisin rrezikun që të mos arrihen objektivat e planifikuara të buxhetit.

Rekomandimi 15 Kryetari i Komunës duhet të siguroj një planifikim më të mirë të shpenzimeve për subvencione, dhe zbatimin e buxhetit sipas ndarjeve fillestare, duhet të jetë objektiv i përhershëm i menaxhmentit.

Çështja 16 - Dhënia e subvencioneve jo sipas kriterëve - Prioriteti i mesëm

E gjetura Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari me datë 07.10.2013 kishte bërë thirrje publike për subvencionimin e fermerëve të komunës me 75 makina mjelëse. Vlera totale e subvencioneve ishte 18,300€. Një ndër kriteret e shpallur në konkurs ishte që "Fermerët të cilët kanë përfituar më herët nga komuna ose ndonjë organizatë donatore nuk do të jenë përfitues". Komuna kishte subvencionuar dy fermer të cilët kishin përfituar makina mjelëse edhe në konkursin paraprak të datës 16.01.2013.

Rreziku Komisioni i caktuar për vlerësimin e aplikuesve kishte anashkaluar kriteret e përcaktuara në konkursin për ndarje të subvencioneve për fermer.

Rekomandimi 16 Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të respektohen kriteret e vendosura në konkurs dhe që komisioni për vlerësimin e aplikuesve është i paanshëm, i drejtë dhe transparent në përzgjedhjen e përfituesve. Duhet të ndërmerren masa administrative sipas nevojës.

4.6 Pasuritë dhe detyrimet

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Pasuritë kapitale mbi 1,000€ të regjistruara në vitin 2012 ishin 171,261,000€, ndërsa deri në fund të vitit 2013 vlera e pasurive të regjistruara ishte 173,655,148€.

Çështja 17 - Mungesa e regjistrimit të plotë dhe të saktë të pasurive - Prioriteti i lartë

Kemi vërejtur që komuna mban regjistra të pasurive kapitale dhe jo kapitale. Mirëpo, këto evidenca nuk ishin të sakta dhe të përditësuara. Ne kemi vërejtur që komisioni i formuar nga menaxhmenti për regjistrimin e pasurive nuk i kishte evidentuar në raportin e tij këto pasuri si: objekti i sallës së sportit, objekti i Shkollës serbe "Vëllezërit Akqiq", tri autoambulanca, dy vetura kombi, një veturë golf 4, dhe një veturë toyota, si dhe 17 shtretër medicinal të dhuruara nga donatori "Clinique de Joli Mont-Gjeneva" nuk figurojnë në regjistrin e pasurive.

Gjatë rishikimit të regjistrimit të pasurisë nën 1,000€ ne kemi vërejtur që komuna i kishte regjistruar gabimisht 52 makina mjelëse si pasuri të komunës në vlerë prej 12,688€. Këto pajisje ishin dhënë si subvencione fermerëve të komunës.

Rreziku

Mungesa e regjistrave të plotë të pasurive vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, madje edhe të humben dhe tjetërsohen.

Rekomandimi 17 Kryetari i Komunës duhet të siguroj që komisioni i formuar nga menaxhmenti të vlerësoj të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës. Gjithashtu, menaxhmenti duhet të monitoroj edhe rezultatet e vlerësimit.

4.6.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 ishte 1,246,033€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013, në këtë shumë janë përfshirë edhe faturat e vitit 2014 në vlerë 83,196€.

Shuma e mbetur e detyrimeve të papaguara është mjaft e lartë në krahasim me shumën totale të buxhetit të komunës dhe mund të ketë implikime serioze në arritjen e objektivave të vitit 2014, duke qenë se këto obligime duhet të paguhen nga buxheti i këtij viti.

Çështja 18 - Hyrje në obligime përtej buxhetit të aprovuar - Prioritet i lartë

E gjetura Në fund të vitit komuna ka prezantuar obligime të pa paguara për paga prej 288,474€, për shkak të planifikimit të mangët të buxhetit. 77 punonjës arsimor nuk ishin përfshirë fare në listën e pagave.

Rreziku Dështimi në planifikimin e buxhetit rritë rrezikun se planet e ardhshme të shpenzimeve nuk mund të arrihen për shkak të nevojës për të paguar obligimet e vitit paraprake. Hyrja në obligime me shumë se sa ndarjet buxhetore mund ta sjellë komunën në vështirësi financiare, me mundësinë potenciale që të iniciohen edhe konteste gjyqësore.

Rekomandimi 18 Kryetari i Komunës duhet të diskutojë me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë se si mund të mbulohen detyrimet.

4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

NJAB për vitin 2013 kishte planifikuar të kryej nëntë auditime, dhe kishte arrit që ta realizoj planin në tërësi. Auditimet kishin mbuluar aktivitetet që kanë qenë në proces për vitin 2013.

Ne kemi vlerësuar punën e auditimit të brendshëm. NJAB kishte arritur që të mbuloj fushat me rrezik, duke përgatitur raporte në bazë të standardeve dhe me një kualitet të mirë.

Po ashtu NJAB kishte përgatitur raporte tre mujore ku i kishte dërguar edhe në njësinë qendrore Harmonizuese në Ministri të Financave. Rekomandimet e tij ishin adresuar pjesërisht nga menaxhmenti.

Çështja 19 - Adresimi i rekomandimeve nga NJAB - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi vërejtur se menaxhmenti nuk kishte trajtuar me kujdesin e duhur rekomandimet e dhëna nga NJAB.

Po ashtu, komuna nuk e ka të themeluar komitetin e auditimit që është kërkesë e udhëzimit administrativ nr. 11/2010.

Rreziku Mos funksionimi i komitetit të auditimit dhe adresimi i dobët i rekomandimeve të dhëna nga auditivi i brendshëm kanë ndikuar që shumë prej parregullsive të mos evitohen apo korrigjohen me kohë, dhe si të tilla vazhdojnë edhe më tutje.

Rekomandimi 19 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë aprovimin e Planit të veprimit duke mbuluar afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe formoj komitetin e auditimit të brendshëm në mënyrë që t'i ndihmoj në adresimin e rekomandimeve të dhëna.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar nëse** arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705¹⁹ jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Rekomandimet plotësisht të adresuara | Rekomandimet pjesërisht të adresuara | Rekomandimet e pa adresuara |
|--------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------|
| 2.2 Prezantimi i Pasqyrave Vjetore Financiare | Kryetari duhet të siguroj që në çdo fund vit të themeloj komisionin për inventarizimin e materialeve të mbetura në stoqe, dhe gjendjen e regjistrimeve ta prezantoj në PVF. | | Pjesërisht | |
| 3. Rekomandimet e vitit paraprak | Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve. | | | Jo |
| 4.4.3 Të hyrat e planifikuara | Kryetari së bashku me stafin e tij menaxhues duhet të analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. | | | Jo |
| 4.4.4 Të hyrat nga arsimi joformal me të gatshme | Kryetari duhet të siguroj se të gjitha të hyrat që inkasohen janë në pajtim me rregullat financiare. | Po | | |
| 4.4.5 Ndërtimet pa leje | Kryetari duhet të rishikojë sistemet ekzistuese për të kontrolluar projektet e ndërtimit. | | | Jo |
| 4.4.6 Inkasim i dobët për taksë për ushtrimin e veprimtarisë | Është përgjegjësi e Kryetarit që të gjejë mekanizmat e duhur dhe të shtoj kontrole mbi të gjithë ata që janë borxhlinjtë ndaj komunës, me qëllim të inkasimit dhe zvogëlimit të borxheve ndaj komunës. | | | Jo |

| | | | | |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|------------|----|
| 4.4.7 Lokalet e dhëna me qira | Kryetari duhet të zbatoj një proces regjistrimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, i cili do të shqyrtohej të paktën çdo gjashtë (6) muaj nga një zyrtar i lartë. | | Pjesërisht | |
| 4.5.1.8 Avansi dhe puna shtesë për renovim të sallës | Kryetari duhet të siguroj se komuna ka staf të mjaftueshëm profesional për përgatitjen e para masës me të gjitha elementet e duhura, dhe ka kontroll të duhur në prokurim dhe menaxhim të projekteve. | | | Jo |
| 4.5.1.9 Nënshkrimi i kontratës pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve | Kryetari duhet të ketë parasysh se nuk duhet të hyjë në obligime pa pasur fonde të mjaftueshme. | | | Jo |
| 4.5.1.10 Vonesa në realizimin e projekteve | Kryetari duhet të siguroj se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për çdo projekt dhe në asnjë rast nuk do të lejoj që projektet të ngecin si të pa përfunduara. | | | JO |
| 4.5.1.11 Blihen produkte me çmim dyfish më të lartë se çmimi i tregut | Kryetari duhet të siguroj se prokurimi ka hulumtuar tregun para së të zhvilloj procedura të prokurimit me koutim çmimeve. | | | Jo |
| 4.5.1.12 Mungon kërkesa nga drejtorja përkatëse | Kryetari duhet të siguroj se aktivitetet e tilla sportive kanë një arsyeshmëri që paraja publike është shpenzuar dhe është justifikuar me dokumentacionin mbështetës. | Po | | |
| 4.5.2.13 Pagesa të drejtpërdrejta nga Thesari | Kryetari duhet të ketë parasysh të vendos disiplinë financiare që të gjitha faturat t'i paguaj me kohë. | | | JO |
| 4.5.2.14 Nuk justifikohet vlera e Memorandum të mirëkuptimit | Kryetari duhet të siguroj se asnjë pagesë nuk do të lejohet para se të konfirmohet se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për certifikim | Po | | |

| | | | | |
|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|------------|----|
| 4.5.3.15 Të Dhënat e Personelit | Kryetari duhet të siguroj se asnjë rekrutim i stafit nuk do të bëhet para se pagat të jenë siguruar. Gjithashtu, rasti duhet të rishikohet dhe të gjitha pagesat ndaj stafit të bëhen sa më parë, si dhe praktikantët e tilla të mos përsëriten. | | | JO |
| 4.5.3.16 Emërimi i dy auditorëve të brendshëm pa konkurs | Kryetari duhet të ndërpre praktikantët e tilla të rekrutimit, dhe për çdo pozitë duhet të zbatohet dhe përfillë kërkesat që dalin nga Ligji për Shërbimin Civil, | PO | | |
| 4.5.4.17 Mosarsyeshmëri e ndihmës financiare | Kryetari të miratojë një rregullore për subvencioneve. Shpenzimet e planifikuara për subvencioneve duhet të shpenzohen vetëm në këtë fushë. | | | JO |
| 4.6.1.18 Mungojnë raporte për pajisjet e çregjistruara | Kryetari duhet të siguroj që sa më parë të kërkojë nga zyrtari i pasurisë që për të gjitha pasuritë që janë në regjistër, të konfirmoj ekzistencën e tyre. | | | JO |
| 4.6.2.19 Mbledhja e taksave në firmë dhe Tatimi në pronë | Kryetari duhet të përgatitë një Plan Veprimi ku do të propozohen udhëzime të qarta për të gjithë sektorët relevant të komunës për ngritjen e inkasimeve. | | Pjesërisht | |
| 4.7.20 Hyrje në obligime pa fonde të zotuar | Kryetari duhet të siguroj një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. | | | JO |
| 5.21 Mungesa e një plani të veprimit | Kryetari duhet të bëjë një Plan Veprimi të zbatueshëm, duke I konfirmuar zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve. | Po | | |